



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:207433
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06207694

K.DH.SH.II.nr.1739/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Dren Rugova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit paditësit-propozuesit të masës së sigurisë D.A. nga Prizreni, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Shqiprim Haliti nga Prishtina, kundër të paditurve 1. B.M., me adresë në rr. “...” nr. 87, Prishtinë dhe 2. Shtëpia Botuese “D...” Sh.P.K. me nr. të biznesit ... dhe me seli në Pejë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate Vjosa Shkodra nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërpropozuesit, të dytë të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr. 588/24 e datës 21.08.2024, me datën 23.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e kundërshtarit të sigurimit Shtëpia Botuese “D...” Sh.P.K, me seli në Pejë, dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 588/24 e datës 21.08.2024.

A r s y e t i m

1 (5)

Gjykata Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor KE.nr.588/24 e datës 21.08.2024, ka vendosur si në vijim;

“I.APROVOHET si i bazuar propozimin i paditësit-propozuesit të masës së përkohshme D.A. nga Prizreni ashtu që CAKTOHET masa e përkohshme dhe URDHËROHET i padituri i dytë-kundërshtari i sigurimit Shtëpia Botuese“D...” me seli në Pejë, që ta tërheqë nga qarkullimi në treg librin “U...” me autore D.A., duke kërkuar nga të gjitha libraritë dhe librashitësit tek të cilat e ka shpërndarë librin për shitje që t’i kthejnë ekzemplarët e librit.

II.Masa e sigurimit mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër nga ana e Gjykatës.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërpropozuesi, i dytë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale,vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe përshkak të vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ose të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Propozuesi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë edhe pse ankesën e ka pranuar me datë 05.09.2024.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Propozuesi i masës së sigurimit paditësi/propozuesi i masës së sigurimit D.A. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Shqiprim Haliti nga Prishtina, me datën 23.07.2024, ka paraqitur padi për kompensim për shkeljen e të drejtës së autorit me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit Shtëpia Botuese “D...” Sh.P.K”, me seli në Pejë, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme të sigurimit ndaj të paditurës së dytë Shtëpia Botuese “D...” (tutje si kundërshtari i sigurimit) dhe të detyrohet e njëjta, që librin “U...” me

autore D.A., ta tërheqë nga qarkullimi nga të gjitha libraritë tek të cilat e ka shpërndarë për shitje, dhe t'i kthejnë të gjitha ekzemplarët e librit.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së perkohshme ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se bazuar në nenin 185 të LDADP-së, propozuesja e sigurimit si autore e librit "U...", fakt ky jo kontestues mes palëve ndërgjyqëse, ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të veprës së sajë. Po ashtu ka cek se nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse gjykata gjeti se nuk është kontestuese fakti se kundërshtari i sigurimit Shtëpia Botuese "D..." ka shtypur 500 ekzeplarë të librit "U..." me autor propozuesja D.A., e po ashtu nuk është kontestuese fakti se kundërshtari i sigurimit, një pjesë të ekzeplarëve të librit i ka hedhur në treg për shitje, fakt ky i cili provohet edhe nga vet raporti i shitjes i dorëzuar si provë nga kundërshtari i sigurimit nga e cila evidentohet se 45 ekzemplarë të librit "U..." janë shitur nga ky i fundit tek palët e treta, andaj, me vet faktin që kundërshtari i sigurimit pohon se ka hedhur në treg përmes shitjes 45 ekzemplarë të librit të propozueses se ka përfutuar financiarisht prej shitjes së tyre, e për më tepër e ka ftuar propozuesen që të kompensohet për një pjesë të fitimit të realizuar nga ekzeplarët e shitur, krejt kjo pa një marrëveshje të shkruara. Kështu krejt në fund Gjykata e shkallës së parë duke iu referuar dispozitave të lartcekura si dhe duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se propozimi i propozuesit për caktimin masës së perkohshme ndaj kundërshtarit të sigurimit është i bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë të paraparë në nenin 185 të LDADP me të cilën është paraparë se "*Në rast se bartësi i të drejtës paraqet prova të bazuara së i është shkelur e drejta e tij në përputhje me këtë ligj, apo nëse ekziston rreziku i pashmangshëm nga shkelja, gjykata mundet, me kërkesë të*

bartësit të të drejtës, të urdhërojë ndonjë masë të përkohshme e cila është e pranueshme për të siguruar kërkesën e bartësit të të drejtës: 1.1. ndalesën e shkeljeve të pritura apo ndalesën e vazhdimit të kryerjes së shkeljes së supozuar; 1.2. konfiskimin ose heqjen nga qarkullimi të mallrave, të dyshuar për shkeljen e një të drejte sipas këtij ligji, për të parandaluar hyrjen e tyre në treg; 1.3. konfiskimin ose heqjen nga qarkullimi të materialeve dhe mjeteve që kryesisht përdoren në punimin apo fabrikimin e mallrave të dyshimta që shkelin të drejtën sipas këtij ligji,” andaj, sipas shkresave të lëndës gjegjësisht raportit të shitjës së ekzemplarëve të librit, kundërshtari i sigurimit e ka hedhur në treg për shitje 45 ekzemplarë të librit të propozues dhe atë pa marrëveshje të shkruar apo autorizim të propozuesit të masës së sigurisë, ngase edhe sipas nenit 21 par 2 të LDADP-së parashihet se “ *Personat tjerë mund të shfrytëzojnë veprën e autorit vetëm në bazë të autorizimit të autorit për kalimin e të drejtave ekskluzive dhe me kushtet e vendosura pret tij, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe*” e që në bazë të kësaj dispozite propozuesja e sigurimit si autore e librit “U...” e ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të veprës së saj si dhe ka të drejtën ekskluzive që të lejoj apo ndaloj personat e tjerë që të shfrytëzojnë veprën e saj, andaj pasi që nuk ekzistonë një marrëveshje e tillë në mesë palëve në procedurë me të cilën do të argumentonte ndonjë raport detyrimor ndërmjet palëve në procedurë, kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur për caktimin e masës së siguris më hollësisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Kjo gjykate i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të kundërshtarit të masës së sigurimit, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuar, dhe se nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje kontestimore, andaj të gjitha pretendime tjera do të shqyrtohen me rastin e vendosjes meritorë. Andaj, kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së siguris siç është paraparë në nenin 185 të LDADP-së.

Kështu, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 185 të LDADP-së, në ndërlidhje me nenin 142 par.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1739/24,data 23.09.2024

Numri i lëndës: 2024:207433
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06207694

Kryetarja e kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri